



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES**

Nr. _____ prot.,

Datë _____._____.2025

V E N D I M

Nr.16, datë 25.09.2025

PËR

NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 05, DATË 19.05.2025 “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE ORGANIKËS, ELEMENTËT PËRBËRËS DHE VLERAT E PAGËS BRUTO MUJORE SI DHE PËRSHKRIMET E PUNËS, TË AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE” TË KËSHILLIT DREJTUES

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

Z.	Gentian Sala	Kryetar
Znj.	Edlira Dvorani	Anëtar
Z.	Lorenc Bako	Anëtar
Z.	Bleron Dokle	Anëtar
Z.	Armer Juka	Anëtar

dhe sekretare znj. Xhilda Hoxha, në mbledhjen e datës 25 shtator 2025 sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Rregulloren e Brendshme për “Funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare” miratuar me Vendimin Nr.7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP dhe ligjin nr.8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, me propozim të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Jashtë dhe Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, shqyrtoi çështjen me objekt:

Për një ndryshim në vendimin nr. 05, datë 19.05.2025 “Për miratimin e strukturës dhe organikës, elementët përbërës dhe vlerat e pagës bruto mujore si dhe përshkrimet e punës, të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare”, të Këshillit Drejtues

BAZA LIGJORE:

1. Gërmat “a” dhe “b” të pikës 6, të nenit 13 të ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”,

KËSHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor,

1. Projektvendimi i arsyetuar
2. Relacioni shpjegues i projektvendimit

si dhe nga diskutimet në mbledhje mbi çështjen, dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

1. AKEP, në cilësinë e një autoriteti rregullator të pavarur, ka kompetencë të veçantë ligjore për të përcaktuar organizimin e brendshëm dhe strukturën e personelit të vet, në funksion të përmbushjes së detyrave të përcaktuara në legjislacionin përkatës.
2. Këshilli Drejtues i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) është organi përgjegjës për miratimin e elementëve përbërës dhe vlerat e pagës bruto mujore.
3. Projektakti është hartuar në referencë të gërmave a dhe b, të pikës 6, të nenit 13, të ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, konkretisht:
 6. Këshilli Drejtues i AKEP-it ndër të tjera, miraton:
 - a) elementët përbërës të pagës bruto mujore të të punësuarve të institucionit;
 - b) vlerën për çdo element të pagës bruto mujore të të punësuarve të institucionit”.
4. Me vendim të Këshillit Drejtues nr. 05, datë 19.05.2025, është miratuar struktura, organika, elementët përbërës dhe vlerat e pagës bruto mujore si dhe përshkrimet e punës, të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare”, në funksion të garantimit të autonomisë së plotë të një autoriteti rregullator të pavarur.”
5. Pika 3, e Lidhjes nr. 2 “Struktura e pagave në Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare”, e vendimit nr. 5, datë 19.05.2025, përcakton shtesa për natyrë të veçantë pune/kushte pune, si më poshtë:
 - a. Shtesë për natyrë të veçantë pune do të aplikohet për punonjësit me profil teknik, që ushtrojnë veprimtari tekniko -administrative në drejtoritë e AKEP apo tekniko-këshillimore pranë Kryetarit KD dhe kanë formim/arsimim në një nga degët Inxhinieri Elektronike, Inxhinieri informatike, Informatikë, Inxhinieri telekomunikacioni, Inxhinieri Mekanike, Teknologji Informacioni, Informatikë ekonomike, Informatikë biznesi, Inxhinieri matematike informatike, Inxhinieri matematike (në analiza sistemesh), Shkenca kompjuterike.
 - b. Shtesë për kushte pune të vështira dhe të dëmshme për shëndetin do të aplikohet për personelin ndihmës si mirëmbajtës, shofer, pastruese, të cilët punojnë në kushte të vështira të ekspozuar ndaj pluhurave, detergjentëve, peshave të rënda, rrezatimit etj.

POZICIONI	VLERA E SHITESËS (LEKË/MUAJ)
Drejtor Drejtorie, me profil teknik	70, 000
Këshilltar, me profil teknik	70, 000
Përgjegjës sektori, specialist dhe inspektor, me profil teknik	50, 000
Shofer dhe Administrator Godine	25,000
Pastruese	20,000

6. Duke vlerësuar natyrën e punës së përgjegjës të Sektorit të Inspektimit me profil gjithëpërfshirës të ndjekjes së zbatimit të ligjit nr. 54/2024, që ka ky pozicion si dhe nivelin e lartë të përgjegjësisë që lidhet me ushtrimin e detyrave funksionale jashtë ambjenteve të zyrës, është e nevojshme që ky funksion të përfitojë shtesë page për kushte të veçanta pune, në përputhje me parimin e barazisë së trajtimit me pozicionet që kryejnë funksione të ngjashme në fushën teknike.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në pikën 1, të nenit 14 dhe pikës 1 të nenit 15, të ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli Drejtues i AKEP,

V E N D O S I:

1. Ndryshimin e pikës 3, të Lidhjes 2 të vendimit nr. 05, datë 19.05.2025 “Për miratimin e strukturës dhe organikës, elementët përbërës dhe vlerat e pagës bruto mujore si dhe përshkrimet e punës, të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi, të Këshillit Drejtues.
2. Ngarkohen Drejtoritë e Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Jashtë dhe Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i fillon efektet nga data 1 tetor 2025.

Kryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Gentian Sala	Armer Juka	Bleron Dokle	Edlira Dvorani	Lorenc Bako

Lidhja 2

3. Shtesa për natyrë të veçantë pune/kushte pune

- a. Shtesë për natyrë të veçantë pune do të aplikohet për punonjësit me profil teknik, që ushtrojnë veprimtari tekniko-administrative në drejtoritë e AKEP (Drejtoria e Teknologjisë dhe Sigurisë Informatike, Drejtoria e Administrimit dhe Menaxhimit të Burimeve të Fundme dhe Sektori Inspektimit) apo tekniko-këshillimore pranë Kryetarit KD (Këshillat) dhe kanë formim/arsimim në një nga degët Inxhinieri Elektronike, Inxhinieri informatike, Informatikë, Inxhinieri telekomunikacioni, Inxhinieri Mekanike, Teknologji Informacioni, Informatikë ekonomike, Informatikë biznesi, Inxhinieri matematike informatike, Inxhinieri matematike (në analiza sistemesh), Shkenca kompjuterike, si dhe për Përgjegjësin e Sektorit të Inspektimit pavarësisht profilit të tij.
- b. Shtesë për kushte pune të vështira dhe të dëmshme për shëndetin do të aplikohet për personelin ndihmës dhe ekzekutiv, si mirëmbajtës, shofer, pastruese dhe specialist protokoll-arkiva të cilët punojnë në kushte të vështira të ekspozuar ndaj pluhurave, detergjentëve, peshave të rënda, rrezatimit etj.

POZICIONI	VLERA E SHITESËS (LEKË/MUAJ)
Drejtor Drejtorie, me profil teknik	70,000
Këshilltar, me profil teknik	70,000
Përgjegjës i sektorit të inspektimit	60,000
Përgjegjës sektori, specialist dhe inspektor, me profil teknik	50,000
Shofer dhe Administrator Godine	25,000
Pastruese	20,000
Specialist protokoll/arkiva	10,000